



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
DREJTORIA JURIDIKE,BURIMEVE NJERËZORE DHE TIK

Nr. ____ Prot.

Peqin më ____ .12.2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____ .Datë ____ .12.2024

Mbi ndryshimin e VKB Nr.04 datë 01.06.2020 "Miratimin e Rregullores për Organizimin,Funksionimin,Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Peqin".

Në mbështetje të nenit 8 pika 2,neni 9 pika 1.1,shkronja b,neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë17.12.2015"Për vetëqeverisjen vendore",të ndryshuar,propozojmë:

PROPOZIM

1. Ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.04 datë 01.06.2020" *Miratimin e Rregullores për Organizimin,Funksionimin,Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Peqin*",sipas materialit bashkëngjitur pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.
2. Të ngarkohet aparati i Bashkisë Peqin për efektet ligjore që sjell ky projekt-vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi pas konfirmimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Konceptoi

Irena DAKA

Xhesiana DOKJA

Aprovoi

Greta NUKA

Miratoi

Sekretar i Përgjithshëm

Julian MANAHASA

KRYETARI I BASHKISË





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN

DREJTORIA JURIDIKE, BURIMEVE NJERËZORE DHE TIK

Lënda: Relacion për Projekt-vendimin Nr. ____ .Datë ____ .12.2024 Mbi ndryshimin e VKB Nr.04 datë 01.06.2020 "Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Peqin".

Drejtuar: KËSHILLI TË BASHKISË PEQIN

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, neni 9 pika 1.1, shkronja b, neni 64 të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar i propozojmë Këshillit të Bashkisë Peqin ndryshimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.04 datë 01.06.2020 "Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Peqin".

Qëllimi i këtij ndryshimi të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.04 datë 01.06.2020 "Miratimin e Rregullores për Organizimin, Funksionimin, Detyrat dhe Kompetencat e Administratës së Bashkisë Peqin", është bërë në përshtatje dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 38 date 27.09.2024 "Mbi miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur ose të emëruar, nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të Bashkisë Peqin dhe të institucioneve në varësi të Bashkisë Peqin".

Rregullorja ka për qëllim sigurimin e rregullave të qëndrueshme mbi të cilat do të ndërtohen marrëdhëniet ndërmjet niveleve të ndryshme hierarkike të aparatit të Bashkisë së Peqin dhe institucioneve të vartësisë të saj, për një veprimtari me efikasitet dhe transparente të administratës ndaj publikut, si dhe për t'i shërbyer sa më mirë këtij të fundit.

Objekt i kësaj rregulloreje është krijimi i një kadri rregullator për funksionimin me efikasitet dhe efikasitet të veprimtarisë së administratës së Bashkisë së Peqin, si dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të saj dhe mënyrën e bashkëveprimit të organeve të Bashkisë ndërmjet tyre me të tretët, për realizimin e funksioneve dhe kompetencave të saj të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën Shqipërisë.

Duke shprehur në mirëkuptimin e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë Peqin propozojmë miratimin e këtij projekt-vendimi si të bazuar në ligj

Ju faleminderit!

Konceptoi

Irena DAKA

Xhesiana DOKJA

Aprovoi

Greta NUKA

Miratoi

Sekretar i Përgjithshëm

Julian MANAHASA